



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VIII

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Integrim Evropian
Mbledhja nr. 92

Prishtinë: Dt. 18. 9. 2024, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Rrezarta Krasniqi, Fjolla Ujkani, Fridon Lala, Agon Batusha, Alban Bajrami, Shqipe Isufi dhe Time Kadrijaj.

Munguan: Driton Hyseni, Elmi Reçica dhe Blerta Deliu-Kodra.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Adelina Demolli, Ahtere Loxha dhe Safet Beqiri.

Mbledhjen e kryesoi: Rrezarta Krasniqi, kryetare e Komisionit

Kryetarja e komisionit pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë e hapi mbledhjen.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e datës 17.7.2024;
3. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit për sesionin pranveror 2024;
4. Shqyrtimi i Planit të Punës së Komisionit për sesionin vjeshtor 2024;
5. Të ndryshme

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e datës 17.7.2024;

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit për sesionin pranveror 2024.

Kryetarja, tha se ky raport paraqet aktivitetet kryesore të Komisionit për Integrim Evropian për periudhën janar-korrik 2024, gjatë sesionit pranveror, ku përfshihet shqyrtimi i projektligjeve në cilësinë e Komisionit të përhershëm, mbikëqyrja e resorëve të caktuar të Qeverisë së Kosovës dhe të institucioneve tjera që janë përgjegjëse në kuadër të procesit të integritimit evropian të Kosovës, raportimet e ministrave si dhe koordinimin e aktiviteteve të tij me institucionet dhe aktorët e tjerë të përfshirë në këtë proces, si dhe të dhënat statistikore të Komisionit.

Sa i përket raportimit të ministrave, ministrja e punëve të jashtme, nuk na është përgjigjur për raportim asnjëherë sikurse edhe disa ministra të tjerë, me përjashtim të zv.kryeministrit Bislimi, i cili ka qenë më i përgjegjshëm në mbledhjet e Komisionit

Pas votimit, kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri miratoi raportin e punës së Komisionit për sesionin pranveror 2024.

4. Shqyrtimi i Planit të Punës së Komisionit për sesionin vjeshtor 2024.

Kryetarja, tha se Komisioni paraqet të gjitha aktivitetet e tij në planin e punës për sesionin vjeshtor për vitin 2024, ku është paraparë shqyrtimi i projektligjeve, raportimi i zëvendëskryeministrit dhe ministrave, takimi me shefin e Zyrës së BE-së në Kosovë dhe pjesëmarrja në konferenca siç është COSAC, për të cilat data ende nuk dihet Ky plan nuk është statik sipas nevojave mund të plotësohet dhe ndryshohet në ndërkohë.

Time Kadrijaj, theksoi se zakonisht plani i punës varet nga agjenda legjislativë. Ne shpesh kemi pasur ngecje sepse nuk janë sjell me kohë projektligjet e parapara. Si komision nuk e kemi pasur asnjë projektligj në shqyrtim. Aktivitetet mund të plotësohen dhe ndryshohen sipas nevojave.

Pas votimit, kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri miratoi planin e punës së Komisionit për sesionin vjeshtor 2024.

5. Të ndryshme.

Për këtë pike, kryetarja njoftoi se ka një ftesë për Komisionin për të marr pjesë në takimin për Procesin e Berlinit, me datën 8 dhe 9 tetor, janë caktuar edhe emrat e katër deputetëve pjesëmarrës, dy të pozitës dhe dy të opozitës.

Time Kadrija, tha se në këtë legjislaturë është bërë një gabim sepse përfaqësimi duhet të jetë politik. Praktikë parlamentare janë të kenë përfaqësim politik, pavarësisht a është parti opozitare apo në pozitë. Kjo është praktika më e re e instaluar nga kjo qeveri.

Fjolla Ujkani, tha se ftesa ka arritur, dy pozitë dhe dy opozitë dhe ne për atë hyjmë ne garë politike që të kemi përfaqësim më të madh në Kuvend dhe 51% me 7 % është një diferencë e madhe dhe nuk bënë me dal dhe me thanë se kjo Qeveri e cakton kush ka me shkua e kush jo.

Sa i përket përfaqësimit nga opozita ju ka takuar juve me përzgjedh se kush shkon e kush jo dhe kjo nuk ka të bëjë asgjë me Qeverinë sepse secili me rotacion vendos me shkua me përfaqësua Komisionin për Integritet Evropian ne çfarëdo takimi jashtë vendit. Jam dëshmitare se gati në çdo takim jashtë vendit, ka qenë Time Kadriaj, e përfaqësuar nga AAK-ja.

Alban Bajrami, tha se edhe kur nuk vjen ftesa e specifikuar, përqindja na përcakton këtë dhe komunitetet janë të përfshira gjithnjë në Qeveri dhe atëherë kur nuk janë te përfshirë, atëherë i bie se ne kemi përgjegjësi për ta, kurse opozita duhet me u marrë vesh si përfaqësohet. Mendoj se po ju bëhet e padrejtë prej dy partive opozitare, që nuk po duan me ju pas me vete dhe ju duhet të sqaroheni me ta.

Time Kadriaj, mos u sill me arrogancën e numrave sepse në Kuvend janë 6 grupe parlamentare dhe kanë të drejta të barabarta, pavarësisht numrave, nëse vjen ftesa e specifikuar pajtohem, por nëse nuk vjen nuk pajtohem sepse atje nuk do të votojmë, është praktikë dhe është me rregullore të Kuvendit dhe ky përfaqësim është jopolitik, tha Kadriaj.

Kryetarja, tha se në shumicën e ftesave nuk e kanë pasur të specifikuar. Unë si kryetare zgjidhna automatikisht dhe shumica ka ra që të jenë pozitë dhe nga opozita vendosin vetë se kush i përfaqëson, por ka pas ftesa që kanë arritur vetëm për kryetaren dhe nënkryetaren e Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Rrezarta Krasniqi,

Kryetare e Komisionit